

**V E N D I M**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane**

**Gjyqtar Altin Abdiu**

asistuar nga sekretare gjyqësore Marjana Xhamallati, datë 29.01.2014 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike kërkesën penale, që u përket,

**Kërkues:**           **XH.S**, i biri i H. dhe i B., i dtl. (.....), lindur ne (.....) dhe banues ne (.....), ne adresen Rruga “(.....)”, Kompeksi “(.....)”, shtetesi dhe kombesi shqiptare, arsimi i mesem, i pa dënuar, identifikuar me karte identiteti.

**Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tiranë**,përfaqësuar nga prokurori Saimir Hysi.

**Objekti:**           Kundërshtimin e masës së sekuestros.

**Baza ligjore :**       Nenet 212, 217, 218 dhe 301 të K.Pr.Penale.

Në konkluzionet përfundimtare :

- Kërkuesi kërkoi pranimin e kërkesës.
  - Prokurori kërkoi rrëzimin e kërkeses, si të pa bazuar në ligj dhe në prova.
- Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën në tërësi,

**V E R E N**

Me kerkesen e paraqitur për gjykim, kërkuesi XH.S kërkon heqjen e masës së sekuestros të dhëne me “Procesverbalin mbi sekuestrimin e provave materiale” të datës 28.10.2013, nga Oficeri i policisë gjyqësore, Altin Lila në Seksionin Kundër Krimet Ekonomik Financiar, pranë Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, duke shpjeguar se nuk është zbatuar procedura e vleftësimit të sekuestros, parashikuar nga neni 301 i K.Pr.Penale.

Prokurori në seancë gjyqësore kundërshtoi kërkesen objekt gjykimi dhe paraqiti këto pretendime : Çështja është ende në hetim, pasi ne kemi filluar një procedim penal për këtë fak, për shkakun se ankuesi ushtronte veprimtari të paligjshme si “Organizimi i lojrave të fatit”. Ky procedim ka filluar, pasi policia gjyqësore ka bërë verifikimet në vend për faktin se ankuesi ushtronte aktivitet pa qene i licensuar në atë periudhë, pra i kishte mbaruar afati i licensimit.Nuk jemi përpara rastit që ato të jenë marrë, apo levizuar që aty, sendet janë në ruajtje. Deri në përfundim të hetimeve sendet duhet që të jenë në ruajtje, pasi ato kanë lidhje me hetimet. Shpjegoj se ne rastin konkret nuk është bërë vleftesimi i sekuestros, sipas nenit 301/2 të K.Pr.Penale.

Për çështjen objekt gjykimi, Gjykata konstaton se për Procesverbalin mbi sekuestrimin e provave materiale të datës 28.10.2013, i përpiluar nga Oficeri i policisë gjyqësore, nuk është marrë vendim nga prokurori për vleftësimin e sekuestros.

Në nenin 301 të K.Pr.Penale me titull “Vleftesimi i sekuestros”, është parashikuar se :

- 1. Kur vë sekuestron sipas nenit 300, policia gjyqësore shenon ne proceverbal shakun dhe i dorëzon nje kopje te aktit personit te cilit i jane sekuestruar sendet. Procesverbali i dergohet pa vonese... jo me von se dyzet e tetë orë, prokurorit te vendit ku eshte zbatuar sekuestroja.*
- 2. Prokurori brenda dyzet e tetë ore te ardhshem, me vendim te motivuar vleftëson sekuestron, ne qofte se ekzistojne kushtet, ose vendos kthimin e sendeve te sekuestruara. Kopja e vendimit i*

*njoftohet personit te cilit i jane sekuestruar sendet. Kunder tij mund te behet ankim ne gjykate brënda dhjetë ditëve... .*

Ne keto kushte, Gjykata çmon se duhet pranuar kerkesa e paraqitur, si e bazuar ne ligj dhe ne prova, sepse ne rastin konkret nuk rezultoi qe te jene zbatuar kerkesat e nenit 301 të K.Pr.Penale, per vleftesimin e sekuestros.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, në zbatim të neneve 379 - 384 të K.Pr.Penale

### **V E N D O S I**

- A) Pranimin e kërkesës.
- B) Heqjen e masës së sekuestros të dhëne me “Procesverbalin mbi sekuestrimin e provave materiale” të datës 28.10.2013, nga Oficeri i policisë gjyqësore, Altin Lila, në Seksionin Kundër Krimit Ekonomik Financiar pranë Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë.
- C) Shpenzimet proceduriale siç janë bërë.
- D) Kunder këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.
- E) U shpall në Tiranë, më datë 29.01.2014.

**S E K R E T A R E**

**MARJANA XHAMALLATI**

**G J Y Q T A R**

**ALTIN ABDIU**